

burgim për shkak të veprimtarisë kundër regjimit të atëhershëm. Dënimin e vuajti në burgun në Stara Gradishka [Kroaci]. E kanë liruar nga burgun në vitin 1991. Pas fillimit të luftës në Kroaci, Fehmiu me bashkëshorten aderuan në ushtrinë kroate. Fehmiu e kishte gradën e nënkolonelit. Menjëherë pas fillimit të konfliktit në Kosovë, ai dhe bashkëshortja kaluan në UÇK. Ajo ishte në krye të njësitit shëndetësor. Në datën **22.09.1998**, qifti bashkëshortor Lladrovci ka rënë në luftimet me pjesëtarë të forcave serbe në **Gllanasellë/Gladno Selo**. Po atë ditë, kanë rënë edhe Shefqet Zeka dhe Fatime Hetemi. U varrosën me nderime ushtarake në Gllanasellë/Gladno selo pas disa ditësh, kur forcat serbe u tërhoqën nga rajoni. Pas vdekjes së saj, Xhevën e kanë nderuar me gradën e gjeneral-majorit.

Burimet: deklarata N.Z, FDH-33446, deklarata B.H, FDH-34303, J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; Z. Stijović, *Kosmet...*, 55; SHFDUÇK, *Feniksët...4*, 87-193, 197-200.

Ramadan (Islam) Muleta

(10.05.1954, shqiptar nga Korrotica e Epërme/Gornja Koretica, komuna e Gllgocit/Glogovac, sekretar shkollë në Korroticë të Epërme/Gornja Koretica, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Bashkim (Tahir) Muleta

(11.12.1971, shqiptar nga Korrotica e Epërme/Gornja Koretica, komuna e Gllgocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Besim (Rexhep) Muleta

(9.05.1975, shqiptar nga Korrotica e Epërme/Gornja Koretica, komuna e Gllgocit/Glogovac, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Muhamet (Brahim) Krasniqi

(5.10.1975, shqiptar nga Negroci/Negrovce, komuna e Gllgocit/Glogovac, mësues, tre fëmijë)

Ramadani, djali i vëllait të tij, Besimi, dhe ai i axhës, Bashkimi, u bënë anëtarë të UÇK-së në fund të muajit mars të vitit 1998, pas vrasjes së familjes Jashari në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze [të shikohen regjistrimet] dhe vëllezërve Ahmeti në Likoshan/Likošane [të shikohen regjistrimet]. Për shkak të inkursioneve të shpeshta dhe keqtrajttimeve nga ana

e forcave serbe, banorët e Korroticës së Epërme/Gornja Koretica i braktisën shtëpitë e veta në fillim të shtatorit, por pjesëtarë të UÇK-së mbeten në fshat. Familja Muleta u strehua në fshatin Sllatinë/Slatina. Nëna e Besimit, Fatja, u kthye për pak kohë në Korroticën e Epërme/Gornja Koretica më **22.09.1998**. Ishte kjo hera e fundit që ajo i shihte të gjallë Ramadanin dhe Bashkimin.

Muhameti me familje jetonte në fshatin Negroc/Negrovce, ku punonte si mësues. Kur forcat serbe e sulmuan fshatin më **25.09.1998**, familja e Muhametit u strehua në pyllin e afërt, ndërkaq ai u tha familjarëve se po shkonte në Prishtinë/Priština. Në datën 27.09.1998, prindërit e Besimit u nisën për ta vizituar të birin. Rrugës dëgjuan se rreth Korroticës së Epërme/Gornja Koretica ka pasur luftime të rënda. Duke iu afruar fshatit [**Korroticë e Epërme/Gornja Koretica**], në afërsi të gurëthesit, dëgjuan zërat e ushtarëve serbë. I vërejtën edhe makinat e tyre. Vendosën që të ktheheshin dhe e morën rrugën e Sllatinës/Slatina. Pas afro 20-25 minutash, hasën në katër trupa të pajetë që ishin ato të Besimit, Ramadanit, Bashkimit dhe Muhametit. Këtë të fundit e identifikuan në bazë të letërnjoftimit në xhep. Që të gjithë ishin të ekzekutuar me nga një plumb në ballë. Besimi dhe Ramadani i kishin duart të lidhura pas shpine me gjalmë. Po atë ditë, pjesëtarët e UÇK-së u kanë ndihmuar familjarëve rreth varrimit të të vrarëve në fshatin Poklek. Pas mbarimit të luftës, familjarët e Muhametit i kanë rri-varrosur mbetjet e tij mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës Negroc/Negrovce.

Burimet: deklarata R.M, FDH-31850; deklarata S.K, FDH-18070; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Branislav (Dragoljub) Menković

(6.06.1956, serb nga Dolevac, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Vendi i parë i punës i Branislavit ka qenë në policinë e Beogradit. Në vitin 1993, ka kaluar në vendlindjen e tij, në Dolevac. Jetonte në shtëpinë familjare me shoqen Dragicen, vajzat Natalien dhe Milicen, si dhe të ëmën